



## Pyetje për Testimin e Njohurive Moduli 1 Njohuri për kontabilitetin

### A. Rrethoni përgjigjen e saktë

- Cila nga teknologjitë e mëposhtme filloi për herë të parë të modernizojë proceset e kontabilitetit në mesin e shekullit të 20-të?
  - Blockchain
  - Makinat llogaritëse
  - Sistemet në Cloud
  - Inteligjenca artificiale
- Cila organizatë u krijua për të zhvilluar standardet dhe parimet e kontabilitetit në Shqipëri?
  - Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS)
  - Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit (KKK)
  - Banka e Shqipërisë
  - Ministria e Financave
- Në një sistem kontabiliteti me parti njëfishe, cila nga deklaratat e mëposhtme është e vërtetë?
  - Regjistron si debitimet, ashtu edhe kreditimet për çdo transaksion
  - Është më komplekse se sistemi me parti dyfishe
  - Regjistron vetëm njërën anë të çdo transaksioni
  - Përdoret nga njësi ekonomike të mëdha
- Cili parim thotë se shpenzimet duhet të regjistrohen kur ato janë të kryera, pavarësisht se kur bëhet pagesa me para në dorë?
  - Parimi i njohjes së të ardhurave
  - Parimi i përputhshmërisë
  - Parimi i kostos
  - Parimi i konservatorizmit
- Cila nga këto nuk është pjesë përbërëse e sistemit të kontrollit të brendshëm?
  - Mjedisi i kontrollit
  - Vlerësimi i rrezikut
  - Informacioni dhe komunikimi
  - Raportimi financiar
- Cila metodë e kontabilitetit i njeh të ardhurat kur ato realizohen dhe shpenzimet kur janë të kryera?
  - Metoda e kontabilitetit sipas pagesave dhe arkëtimeve
  - Metoda e kontabilitetit sipas angazhimeve të konstatuara
  - Metoda e modifikuar e pagesave.
  - Metoda hibride



7. Cili është qëllimi kryesor i një auditimi?

- a) Për të përgatitur deklaratat financiare
- b) Për të zbuluar mashtrimet
- c) Të japë një opinion mbi ndershmërinë e deklaratave financiare
- d) Për të llogaritur taksat që duhet të paguhen.

8. Cili dokument jep një regjistrim të hollësishëm për pagat dhe ndalesat e një punonjësi për një periudhë të caktuar?

- a) Fatura e blerjes
- b) Listëpagesa
- c) Llogaria bankare
- d) Kartela e llogarisë

9. Cila pasqyrë financiare tregon pozitën financiare të një kompanie në një datë të caktuar?

- a) Deklarata e të ardhurave
- b) Deklarata e flukseve të parave të gatshme
- c) Bilanci
- d) Deklarimi i fitimeve të mbajtura

#### **B. Përgjigjuni nëse është e vërtetë apo e gabuar**

10. Futja e kompjuterëve dhe softuerëve si Microsoft Excel në fund të shekullit të 20-të **nuk pati asnjë** ndikim të rëndësishëm në efikasitetin e departamenteve të kontabilitetit.

E vërtetë \_\_\_\_

E gabuar \_\_\_\_

11. Sistemet kontabël bazuara në cloud janë bërë më të përhapura për shkak të rritjes së punës në distancë, veçanërisht të përshpejtuara nga pandemia COVID-19.

E vërtetë \_\_\_\_

E gabuar \_\_\_\_

12. Inteligjenca artificiale dhe mësimi nëpërmjet instrumenteve kompjuterik përdoren vetëm në për regjistrimin e transaksioneve.

E vërtetë \_\_\_\_

E gabuar \_\_\_\_

13. Kontabiliteti sipas angazhimeve të konstatuara njeh të ardhurat vetëm kur janë arkëtuar paratë në dorë.

E vërtetë \_\_\_\_

E gabuar \_\_\_\_

14. Ndarja e detyrave është më pak e rëndësishme në bizneset e vogla për shkak të madhësisë së tyre të kufizuar.

E vërtetë \_\_\_\_

E gabuar \_\_\_\_



15. Detajet e listëpagesës mund të japë prova të respektimit të ligjeve të punës dhe detyrimeve kontraktuale.

E vërtetë \_\_\_\_

E gabuar \_\_\_\_

16. Një faturë është një dokument kontabël që shërben si një kërkesë për pagesë nga një blerës tek një shitës.

E vërtetë \_\_\_\_

E gabuar \_\_\_\_

17. Kontrollat e brendshme janë projektuar vetëm për të parandaluar mashtrimet.

E vërtetë \_\_\_\_

E gabuar \_\_\_\_

18. Auditimet e jashtme janë të nevojshme vetëm për kompanitë e tregtuara publikisht.

E vërtetë \_\_\_\_

E gabuar \_\_\_\_

19. Parimi i përputhjes kërkon që shpenzimet të përputhen me të ardhurat në periudhën në të cilën ato janë kryer.

E vërtetë \_\_\_\_

E gabuar \_\_\_\_

### C. Pyetje me përgjigje të shkurtra

20. Pse ndarja e detyrave të pa pajtueshme ka rëndësi në parandalimin e mashtrimeve dhe gabimeve?

21. Si ndryshon baza e kontabilitetit të angazhimeve të konstatuara nga kontabiliteti i pagesave dhe arkëtimeve?

22. Çfarë janë kontrollet kompensuese dhe pse janë të rëndësishme në bizneset e vogla?

23. Listoni tre shembuj të kontrolleve të brendshme që mund të ndihmojnë në zbutjen e rreziqeve në kontabilitet.

24. Çfarë informacioni mund të përdoret nga Listëpagesa për të verifikuar respektimin e kontratave të punës?

25. Pse konfirmimet e palëve të treta janë të rëndësishme në rastet ligjore që përfshijnë mosmarrëveshje financiare?

26. Çfarë duhet të kërkojë një magjistrat kur shqyrton një faturë si pjesë e një çështjeje ligjore?

27. Si mund të shërbejnë Llogaritë bankare si provë në një mosmarrëveshje ligjore?



#### D. Pyetjet me zhvillim

28. Përshkruani shkurtimisht evolucionin e departamentit të kontabilitetit që nga mbajtja e librave në mënyrë manuale deri tek futja e IA-së dhe e mësimit nëpërmjet pajisjeve teknologjike.
29. Analizoni rëndësinë e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (IFRS) në harmonizimin e praktikave të kontabilitetit në nivel global. Si ka ndikuar kjo në korporatat shumëkombëshe?
30. Analizoni rëndësinë e kontroleve të forta të brendshme brenda një organizate. Si përfitojnë këto kontrole si nga njësia, ashtu edhe nga palët e jashtme, si audituesit dhe rregullatorët?
31. Shqyrtoni rolin e evidencës kontabël në mosmarrëveshjet ligjore. Si mund të ndikojnë të dhënat financiare të sakta dhe të hollësishme në rezultatin e një çështjeje?
32. Përshkruani cilat janë sfidat për ndarjen e detyrave në bizneset e vogla me personel të kufizuar dhe zgjidhjet alternative. Si mund të mbajnë këto njësi kontrole të brendshme efektive?
33. Si ka ndryshuar kalimi i programeve të kontabilitetit në cloud (on line) në mënyrën se si bizneset menaxhojnë të dhënat e tyre financiare?
34. Cilët janë zërat kryesorë të pasqyrës së bilancit dhe çfarë informacioni japin ato mbi shëndetin financiar të një njësie ekonomike?
35. Shpjegoni rolin e auditimeve të jashtme në rritjen e besueshmërisë së deklaratave financiare. Si përfitojnë palët e interesuara nga raporti i auditimit?
36. Ju jeni duke shqyrtuar një çështje financiare dhe njësia ekonomike kohët e fundit ka kaluar në një sistem kontabiliteti të bazuar në cloud (on line). Në cilat fusha kyçe do të përqendroheshit për të siguruar integritetin dhe saktësinë e të dhënave financiare?
37. Një kompani dyshon se një punonjës ka përvetësuar fonde. Çfarë elemente do të shqyrtonit për të mbledhur prova dhe çfarë hapash do të rekomandonit për të pakësuar këtë rrezik në të ardhmen?
38. Gjatë një mosmarrëveshjeje ligjore mbi pagat e papaguara, çfarë informacioni do ta konsideronit vendimtar për gjyqtarin për të shqyrtuar çështjen dhe pse?
39. Në një rast mashtrimi duhet të analizohet llogaria bankare e palëve ndërgjyqësore. Cilat transaksione apo modele specifike duhet të kërkojë gjyqtari për të identifikuar mashtrimet e mundshme?
40. Në një rast që ka të bëjë me një mosmarrëveshje për dorëzimin e mallrave, si mund të ndihmojë një faturë për të përcaktuar faktet e transaksionit?